



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 6480/2020

Data: 14.09.2020

**PROCESVERBALI  
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e tetë -VIII- për vitin 2020 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 24.08.2020 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Mallzum Qajani (Nënkryetar i Komunës), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet e Financa). Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim Kulturë Rini dhe Sport), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim, Rural), Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

**RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i informatës mbi raportin e punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2020.
3. Shqyrtimi i propozim vendimit për rialokim dhe transfer të mjeteve në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, mallra dhe shërbime dhe rezerva.
4. Shqyrtimi i propozim vendimit për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale në Komunën e Hanit të Elezit.
5. Shqyrtimi i propozim rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të subjekteve afariste në territorin e komunës së Hanit të Elezit.
6. Shqyrtimi i propozim vendimit për plotësim ndryshimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve.
7. Shqyrtimi i informatës mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2019-2020.
8. Shqyrtimi i informatës për korrje shirjet.
9. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- përveç pikave të rendit të punës të cilat i kemi përcjell në agjendë kemi edhe një material shtesë të cilin ua kemi dërguar ndërkohë, shqyrtimi i propozim vendimit për themelimin e institucionit parashkollorë. Në plan të kuvendit e kemi pasur që në këtë muaj me diskutuar edhe rregulloren për taksa komunal, mirëpo nga ekzekutivi i komunës nuk ka propozim për ndryshim të taksave dhe për atë nuk e kanë proceduar. Propozoj që shqyrtimi i rregullores për taksa, tarifa dhe gjoba komunale për vitin 2021 të përcillet për kuvend dhe nëse nuk ka ndonjë ndryshim marrim vendim që e njëjta rregullore të jetë në funksion edhe në vitin 2021. Për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

Procedojmë me këtë rend të punës:-

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i informatës mbi raportin e punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2020.
3. Shqyrtimi i propozim vendimit për rialokim dhe transfer të mjeteve në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale , mallra dhe shërbime dhe rezerva.
4. Shqyrtimi i propozim vendimit për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale në Komunën e Hanit të Elezit .
5. Shqyrtimi i propozim rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të subjekteve afariste në territorin e komunës së Hanit të Elezit.
6. Shqyrtimi i propozim vendimit për plotësim ndryshimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve.
7. Shqyrtimi i informatës mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2019-2020.
8. Shqyrtimi i propozim vendimit për themelimin e Institucionit parashkollorë.
9. Shqyrtimi i informatës për korrje shirjet.
10. Shqyrtimi i rregullores për taksa, tarifa dhe gjoba komunale për vitin 2021.
11. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Shqyrtimi i informatës mbi raportin e punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2020.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani** thekson:- ky gjashtëmujorë është përshkruar me kovid-19 sikur në të gjithë botë. Materialin e keni pranuar dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:-a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte një zëri.

U VOTUA INFORMATA MBI RAPORTIN E PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR PERIUDHËN JANAR – QERSHOR 2020 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Shqyrtimi i propozim vendimit për rialokim dhe transfer të mjeteve në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale , mallra dhe shërbime dhe rezerva.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Shabi Rexhallari** thekson:- rialokimi i mjeteve është në kategorinë e shpenzimeve kapitale 116 076.30 € , ndërsa pjesa tjetër është rezerva që nuk është shfrytëzuar për shkak të ligjit të pagave dhe këto mjete transferohen në kategorinë mallra dhe shërbime dhe në shpenzime kapitale. Totali për rialokim dhe transfer në shumë prej 262,812.30 €. Në materialin të cilin ua kemi dërguar janë të paraqitura në detale dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- vërejtje kam te çështja e projekteve te shtrimi me kupza betoni në zonat rurale dhe urbane për shkak se janë të përgjysmuara çdo herë . Është mirë ta dimë se cilat projekte janë kryer dhe cilat kanë mbetur. Po ashtu mjetet financiare rialokohen në infrastrukturën shkollore është dashur me potencuar se në cilën shkollë dhe cilat projekte.

**Sabedin Hasallari** thekson:- nga ky ridistininim i mjeteve financiare a ka mbetur ndonjë projekt pa u realizuar për shkak të pandemisë.

**Shabi Rexhallari** thekson:- duke pasur parasysh kërkesat e drejtorive që kanë iniciuar te zyra e prokurimit duhet patjetër të plotësohen mjetet financiare për ato projekte në të cilat kemi pasur mungesë. Disa projekte kemi pasur nga një shumë simbolike pesë deri në dhjetë mijë euro dhe për me u realizuar duhet shuma më e madhe mjeteve por i kemi hequr mjetet dhe i kemi transferuar te projektet e tjera të cilat janë tenderuar . Me këto rialokime dhe transfero përmbushet plani i komunës. Sa i përket projektit të shtrimit me kupëza betoni në zonat urbane dhe rurale për mbledhje të kuvendit do tu a sjelli se për cilat rrugë janë iniciuar procedurat. Infrastruktura shkollore ka të bëjë te shkolla fillore “Ilaz Thaçi” .

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR RIALOKIM DHE TRANSFER TË MJETEVE NË KATEGORINË EKONOMIKE SHPENZIME KAPITALE DHE REZERVA QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

#### **4. Shqyrtimi i propozim vendimit për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale në Komunën e Hanit të Elezit**

**Kryesuesi** thekson:- në vitin 2019 është miratuar rregullorja e re për këshillat lokale dhe mandati ju ka skaduar andaj duhet të zgjidhen këshillat por kjo do të varet prej pandemisë. Është mirë të kemi konsenzues sa i përket komisionit por në kuvend janë të përfaqësuara partitë politike dhe është mirë që për mbledhje të kuvendit partitë politike ti përcaktojnë emrat për anëtarë të komisionit. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Edon Curri** thekson:- mandati i këshillave lokale ka përfunduar në muajin prill të vitit 2020 dhe për shkak të pandemisë nuk kemi mundur me i zhvilluar procedurat për zgjedhjen e këshillave lokale. Këshillat lokale duhet të zgjidhen sipas rregullores së re e cila është miratuar në muajin nëntor 2019. Komisioni që duhet të miratohet në kuvend duhet të jetë prej shtatë anëtarëve që do të jenë katër anëtarë prej kuvendit të komunës, një nga ekzekutivi i komunës, një nga shoqëria civile dhe një nga përfaqësuesit e fshatit. Komisioni pas themelimit ka obligim që në teren ty organizojë zgjedhjet por varet prej pandemisë.

**Teuta Shkreta** thekson:- a kanë të drejtë të rikandidohen kryetarët e këshillave që kanë qenë deri tash.

**Edon Curri** thekson:- rregullorja e përcakton këtë çështje por kanë të drejtë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- nga kush propozohen edhe dy emrat tjerë për me qenë pjesë e komisionit.

**Kryesuesi** thekson:- njërin e dërgon ekzekutivi dhe njërin shoqëria civile se si e dërgon nuk kam informacioni por besoj që ekzekutivi do ta njofton për me dërguar ndonjë përfaqësues për anëtarë të komisionit. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLAVE LOKALE NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

**5. Shqyrtimi i propozim rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të subjekteve afariste në territorin e komunës së Hanit të Elezit.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sevime Laçi** thekson:- si drejtori sa i përket orarit kemi punuar me një vendim të kuvendit të komunës që është miratuar në vitin 2009 dhe është mirë që komuna me pasur këtë rregullore sepse në vendim nuk kanë qenë të përfshira oraret për të gjitha subjektet afariste. Rregullorja është hartuar në bashkëpunim me komisionin për hartimin e akteve ligjore e që në këtë komision është edhe kryetari i komitetit të bizneseve i cili ka dhënë disa propozime. Komisioni ka propozuar që të neni njëmbëdhjetë orari për barnatoret të jetë prej orës tetë deri në ora njëzet e dy dhe një barnatore me qenë në kujdestari një herë apo dy herë një javë. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni

**Kryesuesi** thekson:- neni njëmbëdhjetë është mirë të analizohet sepse është grup interesi për barnatoret dhe duhet të merren kërkesat edhe nga barnatoret dhe qytetarët mos me mbetur keq por edhe barnatoret me qenë të kënaqur.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA PROPOZIM RREGULLORJA PËR FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS TË SUBJEKTEVE AFARISTE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

**6. Shqyrtimi i propozim vendimit për plotësim ndryshimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Menduh Vlashi** thekson:- dy vite që ndajmë bursa me këtë rregullore nuk kemi pasur probleme por në këtë vit patëm ankesa për pikën 15.1.4 Studenti-ja nëse një herë ka perseritur vitin, apo ndërruar fakultetin humbë të drejtën e bursës. Dhe për atë kemi propozuar në kllapa (përjashtim në këtë pikë bëjnë maturantët dhe studentët e vitit të parë të cilët për shkaqe të ndryshme nuk ka mund të regjistrohet në fakultet apo e kanë ndrru fakultetin dhe që nuk kanë marr bursë). Dhe për shkak të ndryshimit të nenit 15.1.4 propozoj të shtohet një nen në fund: 15.2.1 Studentët e vitit të parë që e kanë regjistruar vitin në kontinuitet (pa shkëputje) nga shkolla e mesme të vlerësohen me 5 pikë. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- neni që është propozuar të shtohet mendoj që është një lloj diskriminim që ti shtohen pesë pikë për shkak se mund të jetë pa fajin e atij studenti.

**Menduh Vlashi** thekson:- unë mendoj se nuk është diskriminim sepse nëse regjistrohet studenti në afatin e parë, ndërsa studenti tjetër provon me një fakultet dhe në tjetrin e nuk mund të regjistrohet dhe nuk mund të jetë i barabartë me atë që është regjistruar për herë të parë.

**Sabedin Hasallari** thekson:- nxënësit e shkollës së mesme të cilët janë raste sociale të cilët tregojnë suksese në mësim propozoj me ju ndarë bursa. Nuk po kërkoj që me ju ndarë sikur studentëve bursë në shumë prej 50 € por propozoj që shuma të jetë 30 €. Bursat të cilët ua kemi ndarë studentëve a kanë treguar suksese në fakultet.

**Menduh Vlashi** thekson:- studentët të cilët ishin përfitues të bursës në vitin e parë konkurrojnë për bursë edhe në vitin e dytë dhe tretë që do të thotë kanë pasur suksese, mirëpo ka raste edhe prej atyre që e kanë humbur vitin dhe nuk kanë konkuruar. Sa i përket bursave për shkollë të mesme në rregullore precizohet që kryetari i komunës mund të ndaj mjete financiare edhe për raste të tjera duke parashtruar kërkesë.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR PLOTSIM NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

#### **7. Shqyrtimi i informatës mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2019-2020.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Menduh Vlashi** thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- përveç materialit të cilin e kemi pranuar do të ishte mirë me diskutuar në kuvend edhe si informatë para fillimit të viti shkollorë për shkak të pandemisë.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA INFORMATA MBI SUKSESIN E ARRITUR TË NXËNËSVE NË SHFMU DHE SHML NË FUND TË GJYSMËVJETORIT TË DYTË TË VITIT SHKOLLOR 2019-2020 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

#### **8. Shqyrtimi i propozim vendimit për themelimin e institucionit parashkollorë.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Menduh Vlashi** thekson:- propozim vendimi është bërë që të kompletohen dokumentacioni për me u dërguar në Ministri të Arsimit për licencim të objektit dhe për mbledhje të kuvendit të komunës do të propozohet edhe emri për çerdhen e fëmijëve.

**Teuta Shkreta** thekson:- kush do të i përcakton kriteret sa i përket emrit. Si do të rrjedhin procedurat e punësimit.

**Menduh Vlasi** thekson:-duhet ti shikojmë procedurat dhe do të ja përcjellim kuvendit për votim. Është hapur njoftimi për regjistrim të fëmijëve dhe pas regjistrimit të fëmijëve do të shpallet konkurs.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR THEMELIMIN E INSTITUCIONIT PARASHKOLLORË QË TË PËRCILLET PËR KUVEND.

## 9. Shqyrtimi i rregullores për taksa, tarifa dhe gjoba komunale për vitin 2021

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani** thekson:- dërgimi në kuvendë i kësaj rregullore është për dy arsye dhe arsyeja e parë është se në rregullore potencohet që vlen për vitin 2020 dhe nëse nuk merret vendim në kuvend që për vitin 2021 nuk kemi ndryshime në këtë rregullore dikush mundë të potencon që ka vlejti vetëm për vitin 2020 e nuk vlen për vitin vijues. Ishte një vendim i zyrës ligjore që me marr vendim kryetari i komunës po me qenë se na me disa subjekte afariste kemi konteste gjyqësore e për taksa dhe tarifa autoritet i vetëm për me marr vendim është kuvendi i komunës.

**Kryesuesi** thekson:- si pikë të rendit të punës e përcjellim në kuvend dhe e diskutojmë. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA RREGULLORJA PËR TAKSA, TARIFA DHE GJOBA KOMUNALE PËR VITIN 2021 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND.

## 10. Shqyrtimi i informatës për korrje shirjet.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Zaim Bela** thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA INFORMATI PËR KORRJE SHIRJE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND.

## 11. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- kërkoj nga nënkryetari i komunës që të na njofton rreth pandemisë në komunën e Hanit të Elezit.

**Mallzum Qajani** thekson:- deri në muajin qershor Kosova ka qenë e izoluar edhe nga qarkullimi i qytetarëve dhe infeksionet ishin nën kontroll dhe ishin shtatë raste në Hanit të Elezit. Pas hapjes së kufijve koronavirusi në një far forme e ka humbur kontrollin dhe në komunën e Hanit të Elezit gjatë muajit korrik dhe gushtë kemi pasur nga pak probleme sepse ka pas persona të dyshuar të cilët kanë kërkuar ndihmë në QKMF dhe institucione shëndetësore. Informacionet e saka nuk i kam por për afërsisht të dyshuar janë afër 45 persona , ndërsa në këto dy muaj pozitivë janë shtatë raste, e që prej tyre dy konsiderohen të shëruar dhe pesë janë ende të infektuar.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- ndonjë vdekje a dihet që ka ndodhë prej virusit në Komunën tonë.

**Mallzum Qajani** thekson:- në mbikëqyrje të policisë është bërë varrimi i z.Llokman Brava dhe zyrtarisht që ai person ka qenë pozitiv nuk na ka ardhur asgjë. Si komunë jemi të interesuar që instituti me najë dërguar se a ka qenë ai person i sëmur apo nuk ka qenë.

**Kryesuesi** thekson:- është dashur të lëshohet vendim nga instituti shëndetësorë para se të varroset në mënyrë që të dihet a ka qenë pozitiv apo nuk ka qenë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- sa mundeni si institucion me bërë presione që me u bërë teste sa më shumë , në mënyrë që ta dimë dhe së paku me u mundur për me vendosë nën kontroll sepse po më doket se në Han të Elezit është pa kontroll gjendja.

**Teuta Shkreta** thekson:- sipas udhëzimeve që na i kanë përcjellë personat që kanë sheja vërtetohen nga mjeku dhe duhet të bëhen analizat dhe rëntgeni dhe pastaj pas kontrollës mjeku e përcakton që personi duhet ta bënë testin.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:27

**Procesmbajtësi**

**Avni Bushi**



**Kryesuesi i Kuvendit**

**MSc. Qamush Brava**

